




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. <u>01-1911/13</u>
Dep. <u>02</u>	Br. Prot. <u>01-1911/13</u>
Nr. l faq.	Data
Broj stranica	Datum <u>10.06.2013</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.05.2013, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllët rasti më nr. AKK-03-469\13, për zyrtarin e lartë z. Fehmi Mehmeti, Drejtor jo Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "UNITETI" – Mitrovicë, për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.**

Pas identifikimit të rastit, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-469/13, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Fehmi Mehmeti, Drejtor jo Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "UNITETI" – Mitrovicë, ku është dyshuar për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, pasi që ushtron edhe pozitën e personit të autorizuar dhe pronarit në bizneset private "D.SH. Mira Cont" dhe "D.SH. Miri Cont" si dhe në biznesin tjetër private "D.SH.Dardi Accounting" të gjitha me seli në Vushtrri.

Agjencia kundër Korrupsionit me datën 27.03.2013, e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedurën e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave, zyrtari i lartë z. Fehmi Mehmeti, pasi ka kontaktuar me zyrtarët e Agjencisë ka kërkuar të takohemi dhe të bisedojmë rreth çështjes së ngritur, sipas procedurës është organizuar takimi me z. Mehmeti, me datën 08.05.2013, ku dhe i kemi shpjeguar për

fillimin e hetimeve lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Gjatë takimit zyrtari në fjalë e ka potencuar se ushtron funksionin e Drejtorit jo Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "UNITETI" – Mitrovicë dhe është pronar dhe person i autorizuar në bizneset "D.SH. Mira Cont" dhe "D.SH. Miri Cont" si dhe në biznesin tjetër private "D.SH.Dardi Accounting" të gjitha me seli në Vushtrri.

Gjatë takimit zyrtari në fjalë ka pranuar dëshmitë e AKK-së dhe është zotuar se në afat sa me të shpejtë do të bëjë ndryshimet dhe do të autorizoj personat tjerë që ta udhëheqin me bizneset ku është i regjistruar si pronar dhe person i autorizuar, dhe do ta shmangë çfarëdo situatë që mundë të shkaktoj konflikt të interesit.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë z.Fehmim Mehmeti, ka sjellë në Agjenci dëshmitë e lëshuara nga ARBK-ja, ku dëshmon se ka bartur tek personi I besuar të drejtën e drejtimit të biznesit.

Duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga zyrtari i lartë z. Fehmi Mehmeti, Drejtor jo Ekzekutiv në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave "UNITETI" – Mitrovicë, Konstatohet se : zyrtari i lartë z. Fehmi Mehmeti, ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

